

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME DETARE DURRËS

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme Detare Durrës, me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare” për periudhën nga data 01.01.2012 deri me datë 13.12.2014, dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 159 datë 05.12.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 690/7 datë 05.12.2014, dërguar Z. Gazmir Tahiri, Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme Detare, Durrës, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga auditimi u konstatua se mungon rregullorja e funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme Detare e miratuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, pasi nga Drejtoria e Përgjithshme Detare është hartuar Projektregullorja e Brendshme me nr. 65 prot. datë 15.02.2013, e cila nuk është miratuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, veprim ky, jo në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10109, datë 02.04.2009 “*Për Administratën Detare në Republikën e Shqipërisë*”.

Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet nr. 10 dhe 11, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandoj:

Drejtorja e Përgjithshme Detare të marrë masa që në funksion të detyrave specifike të hartohen dhe miratohen Rregulloret e Brendshme të funksionimit të DPD me gjithë elementët e duhur në funksion të misionit dhe objektivave që ka kjo administratë. Sa më sipër të dërgohet në Ministrinë e Transporteve dhe Infrastrukturës për miratim.

Menjëherë

2. Nga auditimi rezultoi se në Drejtorinë e Përgjithshme Detare nuk ka rregullore dhe instruksione mbi përdorimin, detyrat, funksionimin dhe qëllimin e mjeteve detare (motoskafëve), pasi rezulton dalje në det dhe kryerje detyrash jo në përputhje të kërkesave të nenit 28 të ligjit Nr. 9251, datë 08.07.2004 “*Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë*”.

Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqen nr. 20, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandoj:

Drejtorja e Përgjithshme Detare të marrë masa që në funksion të detyrave specifike të hartohen dhe miratohen rregulloret dhe instruksionet në lidhje me regjimet e lëvizjes, qëllimin dhe përdorimin e mjeteve detare (m/skafëve).

Menjëherë

3. Nga auditimi rezultoi se në Drejtorinë e Përgjithshme Detare nuk ka instruksione mbi normativat e konsumit të karburantit (e specifikuar sipas regjimeve të ndezjes apo lundrimeve), të mjeteve detare (m/skafëve), pasi rezulton e njëjta normë konsumi karburanti si gjatë qëndrimit në bankinë me motorë ndezur, po ashtu edhe gjatë regjimit lundrimor.

Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet nr. 20-21, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandoj:

Drejtoria e Përgjithshme Detare të marrë masa për ngritjen e një komisioni me ekspertë të fushës, për llogaritjen e normativave të konsumit të karburantit nga m/skafët të specifikuar në kushtet e regjimeve të qëndrimit, po ashtu edhe për regjimet e ndryshme të lundrimit.

Menjëherë

4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultuan mangësi pasi implementimi i ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*, nuk është arritur në nivelin e kërkesave që shtron ligji, pasi u konstatua si mungesa e eksperiencës së stafeve menaxheriale ashtu edhe mungesa strukturore, (njësia audituese dhe grupi i menaxhimit strategjik GMS).

Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet nr. 33-38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandoj:

Drejtoria e Përgjithshme Detare të marrë masa për implementimin ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*, për rritjen e eksperiencës së stafeve menaxheriale ashtu edhe për ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik.

Në vijimësi

5. Nga auditimi rezultoi se përfaqësuesit e Drejtorisë së Përgjithshme Detare nuk kanë ndjekur të gjitha shkallët e gjyqimit në proceset gjyqësore, veprime këto, në kundërshtim me kërkesat e paragrafit 62, të Udhëzimit Nr. 2, datë 06.02.2012 *“Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”*, të Ministrisë së Financave.

Gjithashtu nga auditimi ka rezultuar se nuk janë zbatuar disa vendime gjyqësore të formës së prerë.

Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet nr. 29-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandoj:

Përfaqësuesit e Drejtorisë së Përgjithshme Detare të ndjekin me përparësi të gjitha shkallët e gjyqimit si dhe DPD të marrë masat për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

Në vijimësi

6. Nga auditimi i procedurave të dhënies me qera, rezultoi se DPD ka lidhur një kontratë shërbimi me subjekti “” shpk. Nga verifikimi në vend rezultoi se ky subjekt përveç ambientit të marrë me qera shfrytëzonte edhe një sipërfaqe tjetër prej rreth 50 m², veprim ky në kundërshtim me kërkesat e VKM Nr. 529, datë 08.06.2011 *“Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qera, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”*, ndryshuar me VKM Nr. 54, datë 05.02.2014 *“Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qera, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”*.

Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqen nr. 39, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandoj:

Drejtoria e Përgjithshme Detare të marrë masa për të verifikuar sipërfaqen e shfrytëzimit të ambienteve nga ana e subjektit “” shpk, duke reflektuar me ndryshimet përkatëse në kontratën bazë.

Menjëherë

7. Nga auditimi i procedurave të prokurimeve me blerje të vogla rezultuan veprime jo në përputhje me kërkesat e VKM Nr. 1, datë 10.01.2008 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*.

Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet nr. 16-20, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandoj:

Drejtorja e Përgjithshme Detare në bashkëpunim me Agjencinë e Prokurimit Publik, të marrë masa për hartimin e një programi për kualifikimin e komisionit *“Njësia e Prokurimit”*, për të rritur e përmirësuar kapacitetet profesionale.

Në vijimësi

8. Nga auditimi rezultoi se Drejtoria e Përgjithshme Detare me procedurën *“Për prokurimin me vlera të vogla”*, ka realizuar blerjen e shërbimit *“Për pastrimin e godinës së administratës të DPD”* për vitin 2013, jo në përputhje me kërkesat e VKM Nr. 445, datë 11.07.2012 *“Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”*, pasi procedura për pastrimin e godinës së administratës së Drejtorisë së Përgjithshme Detare është shërbim i parashikuar.

Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqen nr. 18, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandoj:

Drejtorja e Përgjithshme Detare në bashkëpunim me Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës të shqyrtojë futjen në organikë të një punonjësi sanitar, me synim shmangien e procedurave të prokurimit të zhvilluara nga DPD me impakt negativ financiar.

Menjëherë

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Investimeve e Projekteve me Financime të Huaja, Shoqërive Publike dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

Shënim: Auditimi i krye nga audituesit Agron Opari, Vasil Vane, Xhovani Domi, më tej u shqyrtua nga k/auditues Mimoza Lloji, Drejtori i Departamentit Xhaferr Xhoxhaj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Sigurimit të Standarteve Ermal Yzeiraj, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT